



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 11 tetor 2024
Nr. Ref.: RK 2554/24

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI61/24

Parashtrues

Agjencia Kosovare e Privatizimit

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit [ARJ. nr. 198/2023]
të Gjykatës Supreme të Kosovës të 21 dhjetorit 2023**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar,
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

- Kërkesa është dorëzuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejme: AKP), (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës). Parashtruesi i kërkesës para Gjykatës përfaqësohet nga Albert Matoshi, ekonomist.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin [ARJ. nr. 198/2023] e Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Supreme) të 21 dhjetorit 2023, në lidhje me Aktvendimin [AA. nr. 614/2023] e Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata e Apelit) të 29 gushtit 2023 dhe Aktvendimin [A. nr. 1191/2023] e Gjykatës Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Themelore) të 17 korrikut 2023.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kësaj kërkesë është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimeve të kontestuara të gjykatave të rregullta, me të cilat, parashtruesi i kërkesës pretendon se janë shkelur të drejtat dhe liritë e tij themelore, të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta) në lidhje me nenet 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuar] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), si dhe në rregullin 25 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 13 mars 2024, parashtruesi përmes postës e dorëzoi kërkesën e tij në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata). Kërkesa e parashtruesit të kërkesës është regjistruar nga Gjykata më 14 mars 2024.
6. Më 23 marsit 2024, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimit [nr. GJR.KI61/24], caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi gjyqtar raportues dhe Vendimit [NrKSH.KI61/24] Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Enver Peci (anëtarë).
7. Më 29 mars 2024, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 25 korrik 2024, Gjykata, përmes postës elektronike, i dërgoi përfaqësuesit të parashtruesit të kërkesës një shkresë plotësuese, me të cilën kërkoi nga ai që të dorëzojë në Gjykatë autorizimin për përfaqësimin e parashtruesit të kërkesës në Gjykatë.
9. Të njëjtën ditë, parashtruesi i kërkesës, përmes postës elektronike, i dërgoi Gjykatës autorizimin për përfaqësim.
10. Më 11 shtator 2024, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Në bazë të shkresave të lëndës, rezulton se personi D.B., gjatë vitit 2020, parashtrroi një kërkesë në Zyrën Kadastrale në Ferizaj, në të cilën kërkoi që ngastra kadastrale [numër P-

72217087-0057913], me sipërfaqe prej 35164 m², e cila gjendet në Zonën Kadastrale Fshat i Vjetër, Komuna e Ferizajt, të regjistrohet në emër të tij.

12. Më 4 prill 2021, Zyra Komunale Kadastrale në Ferizaj nxori Aktvendimin [nr. 84860-2020], me të cilin aprovoi kërkesën e personit D.B. për regjistrimin e paluajtshmërisë lëndore në emër të tij.
13. Më 6 maj 2021, AKP paraqiti ankesë në Agjencinë Kadastrale të Kosovës kundër Aktvendimit [84860-2020] të Zyrës Komunale Kadastrale në Ferizaj të 19 prillit 2021.
14. Më 4 qershor 2020, Agjencia Kadastrale e Kosovës nxori Aktvendimin [nr. 03/3807/20], me të cilin e refuzoi si të pabazuar ankesën e lartcekur të AKP-së. Aktvendimi [nr. 03/3807/20] i është dorëzuar AKP-së më 30 maj 2023.
15. Më 21 qershor 2023, parashtruesi i kërkesës paraqiti në Gjykatën Themelore padinë për inicimin e konfliktit administrativ, në të cilën kërkoi shtyrjen e përmbaramit dhe anulimin e Aktvendimit [nr. 03/3807/20] të Agjencisë Kadastrale të Kosovës të 4 qershorit 2020, si dhe Aktvendimit [4860-2020] të Zyrës Komunale Kadastrale në Ferizaj të 14 prillit 2021.
16. Më 26 qershor 2023, Gjykata Themelore nxori Aktvendimin [A. nr. 1191/2023], në të cilin, nën pikën **I**. urdhëroi parashtruesin e kërkesës që brenda afatit prej 8 ditësh të precizojë dhe plotësojë padinë/propozimin. Nën pikën **II**. të këtij Aktvendimi, Gjykata Themelore paralajmëroi parashtruesin e kërkesës se në qoftë se nuk vepron sipas këtij Aktvendimi si në pikën I, ajo do të nxjerrë aktvendim me të cilin do të hedhë poshtë padinë në kuptim të dispozitës së nenit 33.2 të Ligjit për Konfliktet Administrative (në tekstin e mëtejme: LKA).
17. Në arsyetimin e Aktvendimit të saj, Gjykata Themelore, *inter alia*, theksoi:

“Gjykata me rastin e përgatitjes së shqyrtimit të çështjes, ka gjetur se me padinë e datës 26.06.2023, atakohet vendimi i datës 04.06.2020 dhe 14.04.2021.

Me nenin 27 të Ligjit për Konfliktet Administrative, përcaktohet se: “1. Padia paraqitet brenda tridhjetë (30) ditësh, që nga data e dorëzimit të aktit administrativ përfundimtar palës. 2. Ky afat aplikohet edhe për organin e autorizuar për paraqitjen e padisë, nëse i është dorëzuar akti administrativ. Nëse akti administrativ nuk i është dorëzuar, mund të paraqesë padinë brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e dorëzimit të aktit administrativ palës, në favor të së cilës është nxjerrë akti”.

Në rastin konkret padia e paditësit përmban të meta të tilla që e pamundësojnë procedimin e çështjes, prandaj gjykata konform neneve 27 dhe 33 të Ligjit për Konfliktet Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, ka detyruar paditësin ti eliminoj të metat e cekura në padinë e tij, për shkak të cilave nuk mund të procedojë me çështjen”.

18. Më 12 korrik 2023 (pas skadimit të afatit prej 8 ditësh), AKP paraqiti në Gjykatën Themelore: **i**) propozimin për kthim në gjendjen e mëparshme, dhe **b**) propozimin për plotësim të padisë, duke theksuar:

“Për arsye të pengesave objektive në sistemin e rrjetit të internetit që për pasojë ka shkaktuar defekte në bazën e të dhënave, Paditësi nuk ka arritur që brenda afatit të lartcekur të dërgoj parashtruesin për precizimin dhe plotësimin e padisë sipas kërkesës së kësaj gjykate me aktvendimin A. nr. 1191/2023 të datës 26.06.2023, e të pranuar me datë 27.06.2023.

Duke pasur në konsideratë rrethanat dhe pengesat objektive të rastit si dhe interesin publik i cili përfshihet në objektin e kësaj çështjeje juridike, me respekt, i propozojmë Gjykatës që të aprovoj propozimin për kthim në gjendjen e mëparshme dhe të bëjë të mundur shqyrtimin e plotësimit dhe precizimin e padisë së Paditësit”.

19. Më 17 korrik 2023, Gjykata Themelore nxori Aktvendimin e parë [A. nr. 1191/2023], me të cilin e hodhi poshtë padinë dhe propozimin për plotësim të padisë, si të parashtruar jashtë afatit ligjor, duke theksuar:

“Gjykata me rastin e përgatitjes së shqyrtimit të çështjes, ka gjetur se me padinë/propozimin të datës 26.06.2023, kërkohet anulimi i vendimit të datës 04.06.2020 dhe 14.04.2021, andaj me aktvendimin e datës 26.06.2023, A. nr. 1191/2023, ka detyruar paditësin/propozuesin që në afat prej 8 ditësh të deklarohet për afatshmërinë e padisë nën paralajmërimin se nëse nuk vepronet konform këtij aktvendimi Gjykata e hedh padinë në kuptim të nenit 33.2 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Aktvendimin A. nr. 1191/2023 datë 26.06.2023, për plotësimin e padisë paditësi e ka pranuar me datë 27.06.2023, kurse para Gjykatës ka dorëzuar parashtruesin për plotësimin dhe precizimin e padisë me datë 12.07.2023, duke vepruar kështu në kundërshtim me afatin e përcaktuar në nenin 33 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Paditësit përkundër afati si në aktvendimin A. nr. 1191/2023 datë 26.06.2023, pranë kësaj Gjykate nuk kanë dorëzuar padinë dhe propozimin e plotësuar dhe të precizuar brenda afatit të përcaktuar në këtë aktvendim, por se e ka dorëzuar pas kalimit të afatit të përcaktuar me dispozitë ligjore, duke vepruar kështu në kundërshtim me aktvendimin e Gjykatës dhe dispozitat ligjore të sipërcituara”.

20. Më 19 korrik 2023, Gjykata Themelore nxori Aktvendimin e dytë [A. nr. 1191/2023], me të cilin refuzoi si të papabazuar kërkesën e parashtruesit për kthim në gjendjen e mëparshme.
21. Në arsyetimin e Aktvendimit të saj [A. nr. 1191/2023], Gjykata Themelore, *inter alia*, theksoi:

“[...] sipas dispozitës së nenit 129.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, parashihet se “në qoftë se pala nuk shkon në seancë fare apo e humb afatin për kryerjen e ndonjë veprimi procedural dhe për këtë shkak e humb të drejtën që më vonë të kryej veprimin procedural të lidhur me afat, gjykata do t’i lejoj kësaj pale, me propozimin e saj të kryej më vonë këtë veprim, po që se konstaton se ekzistojnë shkaqe të arsyeshme të cilat nuk kanë mundur të parashikohen e as të evitohen”, kurse me nenin 130 par. 4 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, është paraparë se po që se kthimi në gjendje të mëparshme kërkohet për shkak të mos ruajtjes së afatit për kryerjen e veprimit procedural, propozuesi ka për detyrë që propozimit t’ia bashkëngjisë veprimin e shkruar procedural të pakryer me kohë, ndërsa në rastin konkret nuk ekziston asnjë shkak i arsyeshëm të cilin gjykata do të mund ta pranonte për lejimin e kthimit në gjendjen e mëparshme, për faktin se nga fletë kthesa e datës 27.06.2023 konstatohet dorëzimi i aktvendimit për plotësim, kurse pretendimi rreth defekteve në bazën e të dhënave nuk arsyetohet me asnjë provë dhe po ashtu edhe lidhshmëria e këtij defekti të pretenduar me afatin për precizimin e padisë...”.

22. Gjykata më tej konstaton se parashtruesi i kërkesës vazhdoi procedurën e mëtejshme gjyqësore pranë Gjykatës së Apelit me parashtrimin e ankesës vetëm në lidhje me Aktvendimin [A. nr. 1191/2023] të Gjykatës Themelore të 17 korrikut 2023, me të cilin Gjykata Themelore hodhi poshtë padinë dhe propozimin për plotësim të padisë si të parashtruar jashtë afatit ligjor. Ndërsa sa i përket Aktvendimit [A. nr. 1191/2023] të

Gjykatës Themelore të 19 korrikut 2023, me të cilin Gjykata Themelore refuzoi si të pabazuar propozimin e parashtruesit për kthim në gjendjen e mëparshme, parashtruesi i kërkesës nuk e kontestoi të njëjtin në procedurën e mëtejshme sipas ankesës në Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën Supreme, bazuar në atë që Gjykata konstaton në kërkesë.

23. Duke pasur parasysh këtë, Gjykata në vazhdim të Aktvendimit do të paraqesë rezultatin e procedurës gjyqësore të parashtruesit të kërkesës para Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme vetëm në lidhje me Aktvendimin [A. nr. 1191/2023] e Gjykatës Themelore të 17 korrikut 2023.
24. Parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktvendimit [A. nr. 1191/2023] të Gjykatës Themelore të 17 korrikut 2023, duke pretenduar, *“Shkelje të dispozitave të nenit 30 dhe 33 të Ligjit për Konfliktet Administrative, nenit 182 paragrafi 1, nenit 182.2. (n), nenit 183 paragrafi 1 dhe 184 të LPK-së”*.
25. Më 29 gusht 2023, Gjykata e Apelit nxori Aktvendimin [AA. nr. 614/2023], me të cilin e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, ndërsa Aktvendimin [A. nr. 1191/2023] e Gjykatës Themelore të 17 korrikut 2023, e vërtetoi në tërësi.
26. Në arsyetimin e Aktvendimit të saj [AA. nr. 614/2023], Gjykata e Apelit, *inter alia*, theksoi:

“Gjykata e shkallës së parë me rastin e përgatitjes së shqyrtimit të çështjes, ka gjetur se padia/propozimi i paditësit është jo e plotë, ngase paditësi referuar kërkesës për shtyrje të ekzekutimit të aktit administrativ nuk ka precizuar në kuptim të Ligjit për Konfliktet Administrative, andaj me Aktvendimin A. nr. 1191/2023 datë 26.06.2023, ka detyruar paditësin që në afat prej 8 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktvendimi, ta bëjë precizimin e kërkesëpadisë duke precizuar saktë aktin administrativ përfundimtar shtyrjen e ekzekutimit të cilit kërkon. Gjykata kishte parasysh se paditësi Aktvendimin A. nr. 1191/2023 datë 26.06.2023, për plotësimin e padisë e ka pranuar me datë 27.06.2023, kurse para Gjykatës ka dorëzuar parashtresën për plotësimin dhe precizimin e padisë me datë 12.07.2023, duke vepruar kështu në kundërshtim me afatin e përcaktuar në nenin 33 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Kolegji i shqyrtoi në baza ligjore pretendimet dhe propozimin si në ankesë të paditësit-propozuesit, ku pretendon se gjykata e shkallës së parë, është dashur të aprovoj kërkesën për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të paditurës, si dhe theksimet e tjera në ankesë, dhe të njëjtat i vlerëson se nuk janë të qëndrueshme dhe të bazuara në baza ligjore, sepse në procedurë të konfliktit administrativ kjo çështje është e rregulluar në mënyrë të plotë sipas dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, ndërsa paditësi nuk ka ushtuar kërkesë, për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ përfundimtar, por ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimit me padi, mirëpo i njëjti edhe pas rekomandimit të gjykatës nuk e ka bërë precizimin e padisë/kërkesëpadisë. Për këto arsye gjykata e shkallës së parë, me të drejtë e hedhë si të jashtë afatshëm propozimin e paditësit, për shkak të metave ligjore, në kuptim të procedurës gjyqësore në konfliktin administrativ, dhe dispozitave ligjore të Ligjit për Konfliktet Administrative”.

27. Parashtruesi i kërkesës paraqiti pranë Gjykatës Supreme kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, përkatësisht Aktvendimit [AA. nr. 614/2023] të Gjykatës së Apelit, duke pretenduar zbatimin e gabuar të LKA-së dhe LPK-së.
28. Më 21 dhjetor 2023, Gjykata Supreme nxori Aktvendimin [ARJ. nr. 198/2023], me të cilin refuzoi si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të paraqitur nga parashtruesi i kërkesës.

29. Në arsyetimin e Aktvendimit të saj [ARJ. nr. 198/2023], Gjykata Supreme theksoi:

“[...] me datë 26.06.2023, parashtruesi ka kërkuar shtyrjen dhe anulimin e aktvendimit të të paditurës Agjencia Kadastrale e Kosovës me nr. 03/3807/20 të datës 04.06.2020, me nr. referent të lëndës 84860-2020 të datës 14.04.2021, ndërsa plotësimin – precizimin e padisë nuk e ka bërë në afatin e përcaktuar nga gjykata, respektivisht në afat prej 8 ditësh siç e ka përcaktuar edhe dispozita nga neni 33 paragrafi 1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejtë kur padinë dhe kërkesën e paditëses e ka hedhur poshtë si të parashtruar jashtë afatit ligjor.

Sipas nenit 27 të Ligjit për konfliktet Administrative është përcaktuar se: “1. Padia paraqitet brenda tridhjetë (30) ditësh, që nga data e dorëzimit të aktit administrativ përfundimtar palës. 2. Ky afat aplikohet edhe për organin e autorizuar për paraqitjen e padisë, nëse i është dorëzuar akti administrativ. Nëse akti administrativ nuk i është dorëzuar, mund të paraqesë padinë brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e dorëzimit të aktit administrativ palës, në favor të së cilës është nxjerrë akti”.

Duke pasur parasysh se afatet e përcaktuara si në dispozitën e lartë cekur për paraqitjen e padisë janë afate prekluzive, dhe me kalimin e afatit humbet e drejta për mbrojtje gjyqësore [...].

Pretendimet e tjera të paditësit të theksuara si në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, lidhur me shkeljet e dispozitave ligjore, nga neni 30 dhe 33 të Ligjit për Konfliktet Administrative, dhe dispozitave thelbësore të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 1 dhe 2, pika (n) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale nga neni 184 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, kolegji i kësaj gjykate i vlerëson se nuk janë të bazuara në fakte të qëndrueshme dhe relevante në baza ligjore, ngase gjykatat e instancave më të ulëta në mënyrë të plotë dhe të drejtë kanë vërtetuar gjendjen faktike dhe aplikuar dispozitat nga e drejta materiale”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

30. Parashtruesi i kërkesës pretendon se aktvendimet e gjykatave të rregullta cenojnë të drejtat dhe liritë e tij të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës në lidhje me nenet 6 (E Drejta për një proces të rregullt) dhe 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të KEDNJ-së.
31. Në mbështetje të shkeljes së nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës, ndër të tjera, pretendon se Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme kanë zbatuar gabimisht dispozitat ligjore lidhur me detyrimet e gjykatës për shqyrtimin paraprak të padisë nga neni 33 i Ligjit për Konfliktet Administrative, pastaj nga nenet 389-393 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, dhe se aktvendimet e kontestuara janë nxjerrë në kundërshtim me nenet 24 dhe 50 të Ligjit për Konfliktet Administrative, dhe se atij i mohohen të drejtat e përcaktuara me ligj dhe me Kushtetutën e Kosovës.
32. Në mbështetje të zbatimit të gabuar të LPK-së nga gjykatat e rregullta, parashtruesi i kërkesës gjithashtu thekson se sipas LPK-së, “Nëse padia nuk përmban disa nga pjesët obligative të theksuara ose shtesave ose është e pakuptueshme, gjykata një padi të tillë nuk mund thjeshtë ta hedhë poshtë por duhet të veprojë si në vështrim të nenit 33 par. 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore”.

33. Parashtruesi i kërkesës konsideron se, “duhet të interpretohet **in favore** kërkesëpadia e paditësit dhe të obligohet gjykata që të veprojë edhe sipas kërkesëpadisë së pa rregullt nëse të metat e padisë nuk pengojnë punën e gjykatës në kontest...”.
34. Më tej, në mbështetje të shkeljes së nenit 32 të Kushtetutës në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës thekson se, “Palët në proces kanë të drejtën të paraqesin vërejtjet që i çmojnë të rëndësishme për çështjen”.
35. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon se, “Sa i përket “zgjidhjes efektive”, GJEDNJ në jurisprudencën e saj ka ndërtuar standarde dhe përkufizime të këtij nocioni. Në rastet *McFarlane v. Ireland* dhe *Riccardi Pizzati v. Italy*, GJEDNJ ka nënvizuar se një mjet juridik është efektiv vetëm nëse është i arritshëm dhe meritohet, derisa në rastet *El-Masri v. Republika e Maqedonisë Veriore* dhe *Kudla v. Polonisë*, kjo Gjykatë ka potencuar se efektshmëria e një mjeti juridik duhet të jetë e zbatueshme si në praktikë, ashtu edhe në rregullimin ligjor”.
36. Parashtruesi i drejtohet Gjykatës me kërkesë që ajo, “i) të deklarojë kërkesën si të pranueshme, ii) të shpallë të pavlefshëm, Aktvendimin e Gjykatës Supreme ARJ. nr. 198/2023 të datës 21.12.2023, sepse ky aktvendim nuk është në pajtim me nenin 31 dhe 32 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 dhe 13 të KEDNJ-së, iii) të kthejë rastin në Gjykatën Supreme për rishqyrtim”.

Dispozitat përkatëse kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të medieeve, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.

[...]

Neni 32

[E Drejta për Mjete Juridike]

“Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj”.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6

(E drejta për një proces të rregullt)

“1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t’i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë”.

Neni 13

(E drejta për zgjidhje efektive)

“Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkella është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare”.

LIGJI nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative

Neni 22

- “1. Padia nuk e ndalon ekzekutimin e aktit administrativ kundër të cilit është paraqitur përveç kur kjo me ligj është parashikuar ndryshe.*
- 2. Me kërkesën e paditësit, organi, akti i të cilit ekzekutohet, gjegjësisht organi që është kompetent për ekzekutim, mund ta shtyjë ekzekutimin deri në vendimin definitiv gjyqësor, nëse ekzekutimi do t’i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do t’i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar.*
- 3. Bashkë me kërkesën për shtyrje duhet paraqitur prova, që tregon se padia është parashtruar.*
- 4. Për shtyrje të ekzekutimit, organi kompetent nxjerr vendimin brenda tri (3) ditëve nga data e marrjes së kërkesës për shtyrje.*
- 5. Organi nga paragrafi 2. i këtij neni mund të shtyjë ekzekutimin e aktit të kontestuar edhe për shkaqe të tjera të arsyeshme deri në vendimin definitiv gjyqësor, nëse nuk është në kundërshtim me interesin publik.*
- 6. Paditësi mund të kërkojë edhe nga gjykata shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ deri në marrjen e vendimit gjyqësor, sipas kushteve të parapara në paragrafin 2. të këtij neni”.*

Neni 23

Kompetenca dhe mjetet juridike

- “1. Për paditë kundër akteve administrative të të gjitha organeve vendos gjykata kompetente për çështjet administrative në shkallë të parë, nëse me dispozita të tjera ligjore nuk është përcaktuar ndryshe.*
- 2. Kundër vendimit të nxjerrë në konfliktin administrativ, ankesa mund të paraqitet te gjykata kompetente për çështje administrative e shkallës së dytë”.*

Neni 24

- “1. Kundër vendimit të formës së prerë të gjykatës kompetente për çështje administrative të shkallës së dytë, pala mund të parashtrojë Gjykatës Supreme të Kosovës kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor.
2. Kërkesa nga paragrafi 1. i këtij neni mund të parashtrohet vetëm për shkak të shkeljes të drejtës materiale ose të shkeljeve të dispozitave të procedurës, që do të mund të kishte ndikim në zgjidhjen e çështjes.
3. Mbi kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit të gjykatës vendos Gjykata Supreme e Kosovës”.*

Neni 30

“Në padi duhen të përfshihen: emërtimi i gjykatës të cilës i paraqitet padia, emri, mbiemri dhe vendbanimi, respektivisht selia e paditësit dhe e të paditurit, akti administrativ kundër të cilit është drejtuar padia, arsyet pse ngrihet padia, si dhe në cilin drejtim dhe vëllim propozohet anulimi i aktit administrativ. Bashkë me padinë duhet të bashkangjitet akti që kontestohet në origjinal ose kopje”.
[...]

Neni 33

*“1. Nëse padia nuk është e plotë, është e pakuptueshme ose ka të meta, kryetari i kolegjit do të ftojë paditësin, që brenda afatit prej tetë (8) ditëve t’i mënjanojë të metat e padisë. Në ftesë duhet të ceken udhëzimet për të mënjeluar të metat e padisë dhe paralajmërimi për pasojat që do të lindin nëse nuk vepron sipas kërkesës së gjykatës.
2. Nëse paditësi, brenda afatit të cekur, nuk i mënjanon të metat e padisë, kurse ato janë të atilla që e pamundësojnë zhvillimin e procedurës, gjykata do ta hedhë poshtë me vendim padinë, nëse nuk konstaton se akti administrativ i kontestuar është i pavlefshëm”.*

Neni 50

*“1. Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor i dërgohet gjykatës brenda tridhjetë (30) ditësh nga data e pranimit të vendimit kundër të cilit pala paraqet kërkesën.
2. Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë paraqitet brenda nëntëdhjetë (90) ditëve nga data kur u është dërguar palëve vendimi, kundër të cilit paraqitet kërkesa”.*

Pranueshmëria e kërkesës

37. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtuesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parapara me Ligj dhe të parashikuara më tej me Rregullore të punës.
38. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

Neni 113

[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

[...]

39. Gjykata në vazhdim shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen në Ligj, përkatësisht në nenet 47, 48 dhe 49 të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individit mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht...”.

40. Përkitazi me përmbushjen e kriterëve të lartcekura, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës është: i) palë e autorizuar, në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës; ii) ai konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit [ARJ. nr. 198/2023] të Gjykatës Supreme të 21 dhjetorit 2023; iii) i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës dhe nenit 47.2 të Ligjit; iv) ka specifikuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë, të cilat konsideron se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit; dhe v) kërkesën e ka parashtruar brenda afatit ligjor prej 4 (katër) muajve, siç parashihet në nenin 49 të Ligjit.
41. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë siç përcaktohen në rregullin 34 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 34 (2) i Rregullores së punës përcakton se:

“Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, kur parashtruesi/ja nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij/saj”.

42. Rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, si dhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajtja e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës (shih rastet e Gjykatës KIO4/21, me parashtruese [Nexhmije Makolli](#), Aktvendim për papranueshmëri i 12 majit 2021, paragrafi 26; dhe [KI175/20](#), me

parashtruese [Agjencia Kosovare e Privatizimit](#), Aktvendim për papranueshmëri i 27 prillit 2021, paragrafi 37).

43. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohemi të njëjtave si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkëljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”; dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta”.
44. Në këtë kontekst, dhe në vazhdim, për të vlerësuar pranueshmërinë e kërkesës, përkatësisht, për të vlerësuar nëse në rrethanat e këtij rasti kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata fillimisht do të rikujtojë thelbin e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës. Në vlerësimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
45. Andaj, Gjykata fillimisht rikujton se rrethanat e rastit ndërlihen me kërkesëpadinë e ushtruar nga parashtruesi i kërkesës në Gjykatën Themelore, në të cilën ka kërkuar shtyrjen e përmbarimit dhe anulimin e Aktvendimit [nr. 03/3807/20] të Agjencisë Kadastrale të Kosovës të 4 qershorit 2020, si dhe Aktvendimit [4860-2020] të Zyrës Komunale Kadastrale në Ferizaj të 14 prillit 2021, me të cilin personit D.B. i njihet e drejta që në emër të tij të regjistrojë pronësinë në kadastrën e paluajtshmërive. Gjykata Themelore ia ktheu kërkesëpadinë parashtruesit si të paplotë, duke i dhënë atij një afat prej 8 ditësh për ta plotësuar atë.
46. Prandaj, sipas Aktvendimit të Gjykatës Themelore, Gjykata konstaton se Aktvendimin për plotësimin e kërkesëpadisë, parashtruesi i kërkesës e pranoi më 27 qershor 2020, dhe si rrjedhojë ka pasur afat deri më 5 korrik 2020, për të plotësuar padinë dhe kërkesëpadinë. Megjithatë, më 12 korrik 2020, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatën Themelore, i) propozimin për kthim në gjendjen e mëparshme, dhe b) propozimin për plotësim të padisë, me arsyetim se lëshimi i afati ka ndodhur “për arsye të pengesave në sistemin e rrjetit të internetit që për pasojë ka shkaktuar defektet në bazën e të dhënave”.
47. Gjykata konstaton se Gjykata Themelore, fillimisht, me Aktvendimin [A. nr. 1191/2023] e 17 korrikut 2023, hodhi poshtë si të paafatshme padinë dhe propozimin për plotësimin e padisë, ndërsa propozimin për kthim në gjendje të mëparshme e refuzoi si të pabazuar me Aktvendimin [A. nr. 1191/2023] e 19 korrikut 2023.
48. Prandaj, parashtruesi i kërkesës, siç vëren Gjykata, paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit vetëm kundër Aktvendimit [A. nr. 1191/2023] të 17 korrikut 2023, me të cilin Gjykata Themelore hodhi poshtë padinë dhe propozimin për plotësimin e padisë si të paraqitur jashtë afatit ligjor.
49. Rrjedhimisht, për Gjykatën është e qartë se përmes aktvendimeve, fillimisht Gjykata e Apelit sipas ankesës dhe më pas Gjykata Supreme sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, shqyrtuan pretendimet ankimore të parashtruesit të kërkesës vetëm në lidhje me Aktvendimin [A. nr. 1191/2023] e Gjykatës Themelore të 17 korrikut 2023.

50. Parashtruesi i kërkesës konsideron se pikërisht këto aktvendime cenojnë të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si dhe me nenin 32 të Kushtetutës në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së.

Përkitazi me shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së

51. Shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës e ndërlidh vetëm me zbatimin e gabuar të dispozitave ligjore nga neni 33 i LKA-së, si dhe nga nenet 389-393 të LPK-së, duke konsideruar se *“këto aktvendime të gjykatave të rregullta janë nxjerrë në kundërshtim me nenet 24 dhe 50 të Ligjit për Konfliktet Administrative”*.
52. Në shqyrtimin e këtyre pretendimeve, Gjykata thekson se në thelb pretendimet e parashtruesit të kërkesës ndërlidhen me zbatimin e gabuar të ligjit në fuqi nga gjykatat e rregullta në procedurën e cila është iniciuar nga parashtruesi i kërkesës me padinë dhe kërkesëpadinë. Gjykata, në pajtim me praktikën e saj gjyqësore dhe praktikën e GJEDNJ-së, pikërisht këto pretendime i konsideroi si *“pretendime të shkallës së katërt”*.
53. Në kontekst të kësaj kategorie pretendimesh, Gjykata thekson se bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe duke marrë parasysh veçoritë e saj, siç janë përcaktuar përmes KEDNJ-së, parimin e subsidiaritetit dhe doktrinën e shkallës së katërt, ajo vazhdimisht ka theksuar dallimin në mes të *“kushtetutshmërisë”* dhe *“ligjshmërisë”* dhe ka pohuar se nuk është detyrë e saj të merret me gabime të fakteve ose të ligjit, që pretendohet se janë bërë nga një gjykatë e rregullt, përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë ose me KEDNJ (shih, në këtë kontekst, ndër të tjera, rastet e Gjykatës [KI96/21](#), parashtrues *Xhelal Zherka*, Aktvendim për papranueshmëri i 23 shtatorit 2021, paragrafi 49; [KI145/20](#), parashtruese *Hafize Gashi*, Aktvendim për papranueshmëri i 22 prillit 2021, paragrafi 33; [KI179/18](#), parashtrues *Belgjyzar Latifi*, Aktvendim për papranueshmëri i 23 korrikut 2020, paragrafi 68; [KI49/19](#), parashtrues *Shoqëria Aksionare Limak Kosovo International Airport S.H.A., “Adem Jashari”*, Aktvendim i 31 tetorit 2019, paragrafi 47; [KI56/17](#), parashtruese *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 35; dhe [KI154/17 dhe KI05/18](#), me parashtrues *Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “Barbas”*, Aktvendim për papranueshmëri i 12 gushtit 2019, paragrafi 60).
54. Gjykata gjithashtu ka pohuar vazhdimisht se nuk është detyrë e kësaj Gjykate të rishikoje konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe se ajo nuk mund të vlerësojë vetë faktet të cilat e kanë bërë një gjykatë të rregullt të marrë një vendim e jo një tjetër. Në të kundërtën, Gjykata do të vepronte si gjykatë e *“shkallës së katërt”*, që do të rezultonte në shpërfilljen e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj (shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së [García Ruiz kundër Spanjës](#), Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe referencat e përdorura aty; dhe shih, gjithashtu rastet e Gjykatës [KI145/20](#), cituar më lart, paragrafi 34; [KI49/19](#), cituar më lart, paragrafi 48; dhe [KI154/17 dhe KI05/18](#), cituar më lart, paragrafi 61).
55. Gjykata, megjithatë, thekson se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe e Gjykatës gjithashtu përcaktojnë rrethana në të cilat duhet të bëhen përjashtime nga ky qëndrim. Siç u theksua më lart, përderisa gjykatat e rregullta kanë detyrë primare të zgjidhin problemet rreth interpretimit të ligjit të aplikueshëm, roli i Gjykatës është që të sigurohet apo të verifikojë që efektet e këtij interpretimi të jenë kompatible me Kushtetutën dhe KEDNJ-në (shih rastin e GJEDNJ-së [Miragall Escolano dhe të tjerët kundër Spanjës](#), Aktgjykim i 25 majit 2000, paragrafët 33-39; dhe shih, gjithashtu, rastin e Gjykatës [KI154/17 dhe KI05/18](#), cituar më lart, paragrafi 63). Në parim, një përjashtim i tillë, ndërlidhet me rastet të cilat

rezultojnë të jenë dukshëm arbitrare, duke përfshirë ato në të cilat, një gjykatë ka “*aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar*” në një rast specifik dhe i cili mund të ketë rezultuar në konkluzione “*arbitrare*” apo “*qartazi të paarsyeshme*” për parashtruesin përkatës.

56. Prandaj, Gjykata, duke shqyrtuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës në kontekst të zbatimit të gabuar të dispozitave ligjore “*nga neni 33 i Ligjit për Konfliktet Administrative, si dhe nga nenet 389-393 të Ligjit për Procedurën Kontestimore*”, në procedurën e vendosjes sipas ankesës së tij nga Gjykata e Apelit, përkatësisht sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit nga Gjykata Supreme, konstaton se sipas Aktvendimit të Gjykatës Themelore, parashtruesi i kërkesës ka pasur një afat ligjor prej 8 ditësh për të “*mënjanuar të metat në padi*” që është në përputhje të plotë me nenin 33 të LKA-së, sepse është evidente se Gjykata Themelore, në procedurën e vlerësimit të përmbushjes së kushteve të parapara procedurale të padisë së parashtruar, konstatoi se padia dhe kërkesëpadia, si të tilla, nuk i plotësonin të gjitha kriteret nga neni 30 i LKA-së dhe se padia, si e tillë, nuk mund të shqyrtohej në kuptimin substancial.
57. Nga procedura gjyqësore e iniciuar nga parashtruesi i kërkesës, Gjykata konstaton se Gjykata Themelore, në përputhje me nenin 33 paragrafi 2 të LKA-së, në Aktvendimin e saj, i ka dhënë parashtruesit të kërkesës mundësinë që brenda afatit të përcaktuar prej 8 ditësh të mënjanojë të metat nga padia dhe kërkesëpadia e tij, me “[...] *paralajmërimin se në qoftë se nuk vepron sipas këtij aktvendimi, do t’ia hedhë poshtë padinë në kuptim të dispozitës së nenit 33.2 të LKA-së*”.
58. Prandaj, është më se evidente se parashtruesi i kërkesës ka pasur një afat shprehimor prej 8 ditësh të përcaktuar me dispozitat e LKA-së, brenda të cilit ai duhej të ndërmerre veprime të caktuara procedurale për të mënjanuar të metat në padi dhe kërkesëpadi që janë evidentuar nga Gjykata Themelore në Aktvendimin e saj. Duke pasur parasysh se Aktvendimi i Gjykatës Themelore është pranuar nga parashtruesi i kërkesës më 27 qershor 2020, rezulton se afati prej 8 ditësh për plotësimin e padisë dhe kërkesëpadiës ka përfunduar më 5 korrik 2020.
59. Gjykata duhet të theksojë se afati i përcaktuar prej 8 ditësh nga Aktvendimi i Gjykatës Themelore është i natyrës prekluzive dhe se parashtruesi i kërkesës brenda këtij afati duhet të ndërmarrë veprime të caktuara procedurale në mënyrë që Gjykata Themelore, në rrjedhën e mëtejshme të procedurës të vendosë për padinë dhe kërkesëpadinë e tij. Gjykata gjithashtu vëren se afati i përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 33 të LKA-së është i natyrës prekluzive, për të cilin afat Gjykata kujdeset *ex officio*, dhe se pas skadimit të tij, pala humb atë që pretendon se i takon. Sipas Aktvendimit të Gjykatës Themelore, ka qenë pikërisht lëshimi i afatit për ndërmarrjen e veprimeve të caktuara procedurale nga parashtruesi i kërkesës i cili çoi në përfundimin se kërkesëpadia dhe propozimi për plotësimin e saj duhet të refuzohen si kërkesa të parashtruara jashtë afatit ligjor.
60. Ky fakt, siç vëren Gjykata, kontribuoi që parashtruesi i kërkesës të paraqesë ankesë në Gjykatën e Apelit, duke pretenduar të njëjtat shkelje të neneve të ligjit që ai pretendon edhe në kërkesën e tij para kësaj Gjykate. Më konkretisht, parashtruesi para Gjykatës së Apelit pretendoi se Gjykata Themelore kishte bërë “*Shkelje të dispozitave nga nenet 30 dhe 33 të Ligji për Konfliktet Administrative, neni 182 paragrafi 1, neni 182.2. (n), neni 183 paragrafi 1 dhe neni 184 të LPK-së*”.
61. Në mbështetje të kësaj, Gjykata konstaton se Gjykata e Apelit në Aktvendimin e saj adresoi në mënyrë të detajuar të gjitha pretendimet ankimore të parashtruesit të kërkesës, duke arritur në përfundimin se parashtruesi i kërkesës, sipas rekomandimit të Gjykatës Themelore, përveç se “*nuk e ka bërë precizimin e padisë/kërkesëpadiës*” brenda afatit të caktuar, ai nuk “*nuk ka ushtruar kërkesë për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ, por ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimit me padi*”, duke vlerësuar se propozimi

i paditësit sipas përmbajtjes së tij nuk është i bazuar në dispozitat ligjore të nenit 22 të Ligjit për Konfliktet Administrative, i cili rregullon mënyrën e parashtrimit të kërkesës për shtyrjen e vendimit përfundimtar të organit administrativ deri në vendosjen meritore të çështjes sipas padisë.

62. Gjykata në vazhdim konstaton se parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar në Gjykatës Supreme kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të Gjykatës së Apelit, duke konsideruar se Gjykata e Apelit ka zbatuar në mënyrë të gabuar “nenet 30 dhe 33 të Ligjit për Konfliktet Administrative, si dhe ka bërë shkelje të neneve 182 paragrafi 1 dhe 2 pika (n) të Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale nga neni 184 i Ligjit për Procedurën Kontestimore”.
63. Në lidhje me pretendimet ankimore të parashtruesit të kërkesës, Gjykata konstaton se Gjykata Supreme ka dhënë përgjigje të hollësishme se për çfarë arsye kërkesa e tij për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit është e pabazuar, duke paraqitur argumente në lidhje me zbatimin e gabuar të neneve 30 dhe 33 të LKA-së, si në vijim: “[...] pas shqyrtimit të kërkesës së paditësit për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor dhe të provave tjera në shkresat e lëndës [Gjykata Supreme] gjen se gjykatat e instancave më të ulëta kanë vendosur drejtë me hedhjen e padisë së paditësit”. Me Aktvendimin e Gjykatës Themelore parashtruesi i kërkesës është paralajmëruar që padinë-propozimin duhet ta dorëzojë në gjykatë në afat prej tetë (8) ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit dhe për pasojat juridike në rast të mosveprimit sipas vendimit të gjykatës.
64. Rrjedhimisht, me një konkluzion të tillë të Gjykatës Supreme pajtohet edhe kjo Gjykatë, sepse parashtruesi i kërkesës ka ditur ose është dashur të dinte se lëshimi i afatit të përcaktuar me ligj do sillte pasoja të caktuara juridike. Kjo posaçërisht për shkak se efekti i kësaj pasoje tashmë është theksuar në Aktvendimin e Gjykatës Themelore, në të cilin thuhet qartë se:
- “Paralajmërohet paditësja se në qoftë se brenda afatit të caktuar si në pikën I të dispozitivit nuk vepron në kuptim të këtij aktvendimi të kësaj gjykate, kjo e fundit do të merr aktvendim me të cilin do t’ia hedhë poshtë padinë në kuptim të dispozitës së nenit 33.2 të Ligjit për Konfliktet Administrative”.*
65. Gjykata gjithashtu nuk mund të mos vërë re se Gjykata Supreme adresoi edhe pretendimet e parashtruesit të kërkesës për interpretimin e gabuar të nenit 182 paragrafi 1 dhe 2 pika (n) dhe nenit 184 të LPK-së, duke konstatuar se këto pretendime të parashtruesit të kërkesës janë të pabazuara dhe se të njëjtat “nuk janë të bazuara në fakte të qëndrueshme dhe relevante në baza ligjore, ngase gjykatat e instancave më të ulëta në mënyrë të plotë dhe të drejtë kanë vërtetuar gjendjen faktike dhe aplikuar dispozitat nga e drejta materiale”.
66. Andaj, Gjykata nga të gjitha shtjellimet e cekura më lart, konsideron se parashtruesi i kërkesës thjeshtë është i pakënaqur me rezultatin e procedurës pranë gjykatave të rregullta, megjithatë pakënaqësia e tij nuk mund vetvetiu të ngrejë një pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë (shih rastin e GJEDNJ-së [Mezotur-Tiszazuqi Tarsulat kundër Hungarisë, kërkesa nr. 5503/02](#), Aktgjykim i 26 korrikut 2005, paragrafi 21).
67. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij se gjykatat e rregullta mund t’i kenë aplikuar në mënyrë të gabuar dispozitat e lartpërmendura të LKA-së dhe LPK-së dhe rrjedhimisht pretendimet e tij për interpretimin dhe aplikimin e gabuar të ligjit të aplikueshëm, kualifikohen si pretendime që bien në kategorinë e “shkallës së katërt” dhe si të tilla, reflektojnë pretendime në nivel të “ligjshmërisë” dhe nuk janë argumentuar në nivel të

“kushtetutshmërisë”. Për pasojë, të njëjtat janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç është përcaktuar përmes paragrafit (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës.

Pretendimet për shkelje të nenit 32 të Kushtetutës në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së

68. Për sa i përket pretendimeve për shkelje të nenit 32 të Kushtetutës në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës e arsyeton këtë shkelje me pretendimin se “*Palët në proces kanë të drejtën të paraqesin vërejtjet që i çmojnë të rëndësishme për çështjen*” dhe se GJEDNJ në jurisprudencën e saj ka ndërtuar standarde dhe përkufizime të këtij nocioni, duke “[...] nënvizuar se një mjet juridik është efektiv vetëm nëse është i arritshëm dhe meritohet, derisa në rastet *El-Masri v. Republika e Maqedonisë Veriore dhe Kudla v. Polonisë, kjo Gjykatë ka potencuar se efektshmëria e një mjeti juridik duhet të jetë e zbatueshme si në praktikë, ashtu edhe në rregullimin ligjor*”.
69. Në mbështetje të kësaj, Gjykata rithekson se pretendimi i parashtruesit të kërkesës se GJEDNJ në praktikën e saj ka përcaktuar parime dhe principe të së drejtës për mjete efektive juridike nga neni 13 i GJEDNJ-së është i bazuar. Për më tepër, Gjykata rikujton se edhe Gjykata Kushtetuese, duke bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, ka theksuar se neni 32 i Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 13 të KEDNJ-së, garanton qasjen në mjete juridike për të adresuar pretendimet për shkeljen e të drejtave dhe lirive, në çfarëdo forme që ato mund të kenë ndodhur (shih rastin e Gjykatës [KI86/18](#), me parashtruese *Slavica Đorđević*, Aktgjykim i 3 shkurtit 2021, paragrafët 124-125; shih dhe rastin e GJEDNJ-së [Boyle dhe Rice kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), nr. 9659/82, 9658 /82, Aktgjykim i 27 prillit 1988, paragrafi 52).
70. Gjykata gjithashtu rikujton se neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike] i Kushtetutës në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së, garanton të drejtën për të përdorur mjet juridik kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat e garantuara në mënyrën e përcaktuar me ligj; (i) të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë është shkelur; dhe (ii) të drejtën për një zgjidhje efektive nëse është shkelur një e drejtë e garantuar me Kushtetutë dhe me KEDNJ (shih, në mënyrë analoge, rastin e GJEDNJ-së *Boyle Rice kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 27 prillit 1998, paragrafi 52). Në vijim, Gjykata duke iu referuar qëndrimin të GJEDNJ-së vëren se kjo e fundit ka vënë në pah se neni 13 duhet të jetë “efektiv” si në praktikë ashtu edhe në ligj (shih rastin e GJEDNJ-së *Ilhan kundër Turqisë*, Aktgjykim i 27 qershorit 2000) dhe se “efektiviteti i mjetit juridik”, në kuptim të nenit 13 të KEDNJ-së, nuk është i kushtëzuar me garancinë për një zgjidhje të favorshme për parashtruesin e kërkesës (shih rastin e GJEDNJ-së *Kudla kundër Polonisë*, nr. 30210/96, Aktgjykim i 26 tetorit 2000, paragrafi 157).
71. Duke shqyrtuar me kujdes pretendimet e parashtruesit të kërkesës në kontekst të parimeve dhe principeve të GJEDNJ-së, si dhe praktikës së saj, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës, në procedurën e mbrojtjes së të drejtave të tij, përkatësisht në procedurën e kontestimit të Aktvendimit të Gjykatës Themelore, ka përdorur mjetet juridike që parashikohen në mënyrë specifike në nenet 23 dhe 24 të LKA-së.
72. Më konkretisht, dispozita e lartcekur e paragrafit 2 të nenit 23 të LKA-së, në mënyrë të qartë përcakton se, “*Kundër vendimit të nxjerrë në konfliktin administrativ, ankesa mund të paraqitet te gjykata kompetente për çështje administrative e shkallës së dytë*”.

73. Nga gjendja e paraqitur faktike dhe nga vendimet e gjykatave është e qartë se parashtruesi i kërkesës ka paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore, duke përdorur në këtë mënyrë mjetin juridik të përcaktuar me ligj.
74. Për më tepër, Gjykata, gjithashtu, konstaton se parashtruesi ka paraqitur kërkesë në Gjykatën Supreme për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor dhe se kjo kërkesë është parashikuar si mjet juridik me nenin 24 paragrafi 1 të LKA-së, por e njëjta është refuzuar nga Gjykata Supreme sepse gjeti se kërkesa është e pabazuar.
75. Duke pasur parasysh këtë, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës në procedurat para gjykatave të rregullta ka përdorur të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj me qëllim të realizimit të të drejtave të tij, dhe se vetë fakti që nuk mori vendimet që ai priste prej tyre nuk e vë në dyshim jo efikasitetin e tyre.
76. Rrjedhimisht, Gjykata i refuzon këto pretendime të parashtruesit të kërkesës si pretendime të kategorisë (ii) të pretendimeve që karakterizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”.
77. Prandaj, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si dhe pretendimet për shkelje të nenit 32 të Kushtetutës në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së janë pretendime qartazi të pabazuara në baza kushtetuese dhe për këtë arsye e deklaroi kërkesën të papranueshme në tërësinë e saj, në pajtim me rregullin 34 paragrafi (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 34 (2) të Rregullores së punës, më 11 shtator 2024, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T’UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtari raportues



Nexhmi Rexhepi

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Gresa Caka-Nimani